



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA PATOS**  
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE  
DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL**

**SPECIALIST AUDITI NË SEKTORIN E AUDITIT TË BRËNDSHËM**

Ne zbatim të nenit 22 dhe 25 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe kreut II, III, IV dhe V, të Vendimit nr.243 date 18.03.2015 të Keshillit të Ministrave “Për pranimin, levizjen paralele, peridhen e proves dhe emerimin në kategorinë ekzekutive”, Bashkia Patos shpall Procedurat e levizjes paralele dhe e pranimit në shërbimin civil për pozicionin:

- **1 vend** në pozicionin Specialist në Sektorin e Auditit.  
- Kategoria e pagës IV-b.

Pozicioni i më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e levizjes paralele! Vetëm në rast se ky pozicion, në përfundim të procedurës së levizjes paralele, rezulton ende vakant, ai është të vlefshme për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në Shërbimin Civil

**Për të dy Procedurat (levizje paralele dhe pranimin në shërbimin civil) aplikohet në të njëjtën kohë!**

**Afati për dorëzimin e dokumentave për:**

**LËVIZJE PARALELE**

**10/10/2022**

**Afati për dorëzimin e dokumentave për:**

**PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL**

**13/10/2022**

---

• **Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin Specialist në Sektorin e Auditit është:**

1. Hartimi i metodave apo udhezimeve për fusha të veçanta të auditimit të brendshëm, në zbatim të manualit të auditimit apo akteve të tjera të Ministrisë së Financave, dhe dërgimi i tyre për miratim në Drejtorinë e Përgjithshme të Auditimit.
2. Hartimi i planeve, vjetore dhe strategjike, për veprimtarinë e auditimit të brendshëm.
3. Ndjekja dhe raportimi periodikisht për gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet, që rezultojnë nga veprimtaritë e tyre audituese, si dhe dhënia e informacionit për Drejtorinë e Përgjithshme të Auditimit, për rekomandimet e pazbatuara.
4. Përgatitja e raporteve, periodike dhe vjetore, dhe dërgimi i tyre në Drejtorinë e Përgjithshme të Auditimit, sipas afateve dhe kërkesave të përcaktuara prej saj dhe të miratuara nga ministri i Financave. Raportet përmbledhëse, në të gjitha rastet, duhet të shoqërohen me evidencat e raportimit për periudhën raportuese, në mënyrë progresive, dhe një vlerësim përmblyës për veprimtarinë audituese për këtë periudhë;
5. Raportimi, pas keshillimit me strukturën përkatëse juridike, të drejtuesi i subjektit të audituar, dhe i njesisë së inspektimit, kur zbulon parregullsi apo veprime, që përbejnë vepra penale;

### **I-Lëvizja paralele**

---

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

## **1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA**

---

### **Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e lëvizjes paralele janë:**

- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori,
- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;

### **Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

- a) të zotërojnë Diplomë “Bachelor” në Shkencat Ekonomike. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- b) Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 3 vjet.
- c) Të ketë marrë certifikuatën e si “Auditues i Brendshëm”.
- d) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- e) Të ketë njohuri të një gjuhe të huaj.

## **1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

---

Kandidati duhet të dërgojë dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e drejtoris së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos, këto dokumenta

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
- Një kopje të jetëshkrimit.
- Nje numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
- Fotokopje e diplomës. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj duhet ta ketë të njesuar pranë Ministrisë së Arsimit.
- Fotokopje e listës së notave. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar.
- Çertifikaten si Auditues i Brendshëm
- Fotokopje të një vleresimi vjetor.
- Fotokopje të aktit të konfirmimit të Satatusit të nëpunësit civil.
- Fotokopje të librezës së punës e plotësuar.
- Çertifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme.
- Fotokopje e letërnjoftimit.
- Vërtetim gjëndjes gjyqësore dhe shëndetsore;

*Dokumentet duhet të dorëzohen drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 07.10.2022.*

## **1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

---

Në datën **10.10.2022**, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos do të shpall në portalin “Drejtorinë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë dhe ne stenden e informimit te publikut listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

Kandidatët, të cilët rezultojnë të pakualifikuar, brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual, paraqesin ankesat me shkrim pranë Drejtorsë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos. Ankesat zgjidhen brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nga data e paraqitjes së tyre.

## **1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA**

---

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a. Njohurite mbi Ligjin Nr.139/2015, “Per veteqeverisjen vendore”
- b. Njohurite mbi Ligjin Nr.152/2013, “Per nepunesin civil”, (i ndryshuar) si dhe aktet neligjore dale ne zbatim te tij;
- c. Njohurite mbi Ligjin Nr.44/2015, date 30.04.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.
- d. Njohurite mbi Ligjin Nr.9131, date 08.09.2003, “Per rregullat e etikes ne administraten publike”;
- e. Njohurite mbi Ligjin nr. 114/2015 “Per auditimin e brendshem ne sektorin publik”.
- f. Njohurite mbi “Manualin e auditimit financiar”;
- g. Njohuritë mbi “Manualin e auditimit e brendshem”

## **1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:**

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë, i ndarë në: 20 pikë përvojë, 10 pikë për trajnime apo kualifikime të lidhura me fushën përkatëse dhe 10 pikë për certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë, në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohet me 60 pikë.

**Totali i pikëve është 100 pikë.**

## **1.6 DALJA E REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Data dhe vendimi i konkurimit do të njoftohet konkurrenteve.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Patos do të shpallë fituesin në Faqen Zyrtare të Bashkisë Patos dhe në portalin e “Drejtorinë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

### **2- Pranimi në Shërbimin Civil**

*Vetëm në rast se pozicioni i publikuar në këtë shpallje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende vakant, ky pozicion do të jetë i vlefshëm për konkurim nëpërmjet procedurës së pranimi në shërbimin civil.*

**Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë personat që janë jashtë shërbimit civil.**

**2.1**

## **KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA**

## **Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil:**

- a. Te jete shtetas shqiptar;
- b. Te kete zotesi te plote per te vepruar;
- c. Te zoteroje gjuhen shqipe, te shkruar dhe te folur;
- d. Te jete ne kushte shendetesore qe e lejojne te kryeje detyren perkatese;
- e. Te mos jete i denuar me vendim te formes se prere per kryerjen e nje krimi apo per kryerjen e nje kundervajtjeje penale me dashje;
- f. Ndaj tij te mos jete marre masa disiplinore e largimit nga sherbimi civil, qe nuk eshte shuar sipas ligjit nr. 152/2013.

## **Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

- a) të zoterojë Diplomë “Bachelor” në Shkencat Ekonomike. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- b) Të kenë eksperiencë pune deri në 1 vitë.
- c) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- d) Te kete njohuri te një gjuhe te huaj.

## **2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

---

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim;
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Çertifikaten si Auditues i Brendshëm
- e- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- f- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- g- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- h- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore.

*Dokumentet duhet të dorëzohen drejtpërsëdrejti në institucionin e Bashkisë Patos, brenda datës 12.10.2022.*

## **2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

---

Në datën **13.10.2022**, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos do të shpallë në portalin e “Drejtorinë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë dhe në stenden e informimit të publikut listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

Kandidatët, të cilët rezultojnë të pakualifikuar, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nga data e njoftimit individua, paraqesin ankesat me shkrim pranë Drejtorsë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos. Ankesat zgjidhen brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nga data e depozitimit të ankesës.

## 2.4

### FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a. Njohurite mbi Ligjin Nr.139/2015, “Per veteqeverisjen vendore”
- b. Njohurite mbi Ligjin Nr.152/2013, “Per nepunesin civil”, (i ndryshuar) si dhe aktet neligjore dale ne zbatim te tij;
- c. Njohurite mbi Ligjin Nr.44/2015, date 30.04.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.
- d. Njohurite mbi Ligjin Nr.9131, date 08.09.2003, “Per rregullat e etikes ne administraten publike”;
- e. Njohurite mbi Ligjin nr. 114/2015 “Per auditimin e brendshem ne sektorin publik”.
- f. Njohurite mbi “Manualin e auditimit financiar”;
- g. Njohuritë mbi “Manualin e auditimit e brendshem”

## 2.6

### MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit, i ngritur pranë Bashkisë Patos.

Totali i pikeve të vlerësimit të kandidatëve është 100 pike të cilat ndahen perkatesisht:

- a. 15 pike për dokumentacionin e dorëzuar;
- b. 25 pikë për intervistën e strukturuar me gojë;
- c. 60 pikë për vlerësimin me shkrim.

## 2.7

### DATA E KONKURIMIT DHE DALJA E REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen e Bashkisë Patos, për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil të kategorisë ekzekutive - për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak, - datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi; Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Bashkisë Patos duke filluar nga data 31/10/2022.

**Drejtoria e Burimeve Njerëzore**

**Bashkia Patos**